



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA**  
**NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION**

---

# **Komisioni i Pavarur për Media**

## **Raporti Vjetor 2008**

**drejtuar**

**Kuvendit të Republikës së Kosovës**

**28 shkurt 2009**

**Telefoni: 038 245 032**  
**Telefaksi: 038 245 034**  
**ueb faqja: [www.imc-ko.org](http://www.imc-ko.org)**  
**E-mail: [info@imc-ko.org](mailto:info@imc-ko.org)**

## **PËRMBAJTJA:**

Parathënie .....	3
Baza ligjore.....	4
Struktura e raportit.....	4
Objektivat e përcaktuara për vitin 2008 dhe realizimi i tyre.....	5
Objektivat për vitin 2009.....	9

### **Kapitulli I**

Këshilli i KPM-së .....	10
Takimet dhe vendimet e Këshillit të KPM-së gjatë vitit 2008.....	11
Organizimi i takimeve publike .....	13
I. <i>Strategjia për licencimin afatgjatë</i> .....	13
II. <i>Krijimi i një kanali mbarëkosovar në gjuhën serbe</i> .....	13
III. <i>Hartimi i strategjisë për digjitalizimin në Kosovë</i> .....	14

### **Kapitulli II**

Zyra e Shefit Ekzekutiv.....	15
Puna e prezantuar sipas strukturës.....	16
Departamenti i Rregullimit të Transmetimit.....	16
<i>Divizioni i Monitorimit</i> .....	16
<i>Divizioni i Licencimit</i> .....	17
<i>Divizioni Ligjor</i> .....	18
<i>Divizioni i menaxhimit Frekuencor</i> .....	23
Departamenti i Administratës.....	25
Sfidat e Zyrës gjatë vitit 2008.....	26

### **Kapitulli III**

Bordi i Ankesave për Media.....	28
Obligimet karshi subjektit Transmetues Publik – RTK.....	29
<i>Reklamimi</i> .....	29
<i>Procesi i nominimit të Bordit të RTK-së</i> .....	29

### **Shtojcat**

- I.    Raporti Financiar
- II.   Vendimi për Taksën për Licencë
- III.  Raporti i KPM-së për strategjitë për licencim dhe digjitalizim
- IV.   Tabela e rasteve Ligjore
- V.    Pasqyrë e subjekteve transmetuese
- VI.   Fig. 1 Skema e re organizative e Zyrës së Shefit Ekzekutiv e aplikueshme nga 2009

## PARATHËNIE

Këshilli i Komisionit të Pavarur për Media (KPM), në bazë të një drafti të përgatitur nga Shefja Ekzekutive e Zyrës së KPM-së, është i nderuar t'i dorëzoj Kuvendit të Republikës së Kosovës raportin e tretë vjetor të saj, siç kërkohet nga Neni 3.8 i Ligjit Nr. 02/L-15 mbi Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim.

Komisioni i Pavarur për Media themelohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Neni 141 KPM është rregullator i pavarur për rregullimin e transmetimit në Kosovë. Puna e KPM-së rregullohet me Ligjin e Kuvendit të Kosovës Nr. 02/L-15, udhëhiqet nga Politikat e saj të Transmetimit, duke u bazuar në praktikat më të mira Evropiane të të drejtave të njeriut, dhe nga interesi publik.

Viti 2008 ishte viti më i rëndësishëm për KPM-në. Pavarësia e KPM-së u garantua edhe nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës e cila hyri në fuqi më 15 qershor të vitit 2008. KPM-ja zëvendësoi 2 anëtarët ndërkombëtar të Këshillit me anëtarë vendor dhe tani KPM funksionon si rregullator me kompetenca të plota.

Viti 2008 gjithashtu shënon një rritje të madhe të njësive audio vizuale të transmetimit që u paraqiten në tregun medial të Kosovës, si subjekte jo-lineare të transmetimit. KPM-ja ka shënuar sukses në licencimin dhe rregullimin e këtyre subjekteve duke u ballafaquar çdo ditë me sfida të reja të cilat vijnë detyrimisht nga një industri mediale që udhëhiqet nga një zhvillim i hovshëm i teknologjisë.

Gjatë vitit 2008, KPM-ja filloi një proces tejet të rëndësishëm për Kosovën: strategjinë për Transmetim Numerik të Kosovës. Bërja e kësaj strategjie kërkon një bashkëpunim gjithëpërfshirës të shumë institucioneve të Kosovës, dhe mund të thuhet pa hezitim që gjatë vitit 2008, KPM ka shënuar një avancim në vendosjen e një bashkëpunimi efektiv me qëllim të arritjes së qëllimeve të përbashkëta për implementimin pa vonesë të transmetimit numerik në Kosovë.

KPM-ja ka bashkëpunuar edhe me institucionet ndërkombëtare në Kosovë siç janë Komisioni Evropian, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Zyra Ndërkombëtare Civile, dhe donatorë të ndryshëm ndërkombëtar në çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me avancimin e skenës mediale në Republikën e Kosovës. KPM-ja mori pjesë në dy takimet e rregullta të Platformës Evropiane të Autoriteteve Rregullative (EPRA), dhe ka vazhduar t'i avancojë raportet me Rregullatorët e Mediave në rajon me qëllim të krijimit të një bashkëpunimi për fushën e koordinimit të spektrit frekuencor dhe shkëmbimit të ndërsjellë të përvojave.

***Këshilli i Komisionit të Pavarur për Media***

***shkurt, 2009***

## **BAZA LIGJORE**

Më 21 prill 2005, Kuvendi i Kosovës ka aprovuar Ligjin nr. 02/L-15 për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim, i cili ka hyrë në fuqi më 8 shtator 2005.

Komisioni i Pavarur për Media është edhe organ kushtetues i përcaktuar me Nenin 141 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Sipas Nenit 3.8. të Ligjit për KPM-në, Këshilli i KPM-së përgatit dhe i paraqet Kuvendit të Kosovës, brenda dy muajve pas përfundimit të çdo viti kalendarik, një raport vjetor duke përfshirë edhe të dhënat e plota në lidhje me përcaktimin dhe zbatimin e politikës së transmetimit, dhënien e licencave dhe të ankesave, sanksionet që zbatohen dhe vendimet në lidhje me to, aktivitetet financiare, aktivitetet e tjera të transmetimit dhe objektivat e projektimit për vitin e ardhshëm.

## **STRUKTURA E RAPORTIT**

Raporti i punës për vitin 2008 i Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media fillon me pasqyrimin e realizimit të objektivave të vitit 2008 dhe me pasqyrim të objektivave të përcaktuara për vitin 2009. Më pastaj bëhet në mënyrë të përmbledhur prezantim i punës së Komisionit të Pavarur për Media përmes punës së Këshillit të KPM-së, Zyrës së Shefit Ekzekutiv dhe Bordit të Ankesave për Media.

Në dy kaptina të këtij raporti, në atë për Këshillin e KPM-së dhe në atë për Bordin e Ankesave për Media i është vënë theks i veçantë procesit të nominimit të anëtarëve të këtyre dy trupave për faktin që këto procedura janë shumë të rëndësishme dhe çojnë peshë në mbarëvajtjen e punës së KPM-së.

## OBJEKTIVAT E PËRCAKTUARA PËR VITIN 2008 DHE REALIZIMI I TYRE

Këshilli i KPM-së për vitin 2008 është përcaktuar që të përmbush obligimin ligjor për:

1. licencimin e operatorëve kabllorë dhe të fruesve të shërbimeve të programeve;
2. nxjerrjen e vendimit për taksën për licencë për subjektet transmetuese;
3. nxjerrjen e rregullores për mbrojtjen e të miturve;
4. hartimin e strategjisë përgatitore për transmetimet digjitale në Kosovë; dhe
5. lëshimin e licencave afatgjate të subjekteve transmetuese.

### *Licencimi i operatorëve kabllor dhe ofruesve të shërbimeve programore përmes kabllor*

Gjatë vitit 2008, ka filluar të zbatohet rregullorja për Distribuimin Kabllor të Programeve Radio Televizive. Sipas rregullores, faza e parë e licencimit ka paraparë regjistrimin e operatoreve kabllorë aktiv. KPM-ja ka regjistruar gjithsej 16 operatorë. Për fazën e licencimit janë paraqitur 10 operator kabllorë. Këshilli i KPM-së, më 9 maj 2008, ka marrë vendim për licencimin e këtyre 10 operatorëve kabllor, ku vetëm 8 prej tyre janë pajisur me licencë të KPM-së më 5 gusht 2008. Këta operatore kabllorë janë:

- |                                   |   |
|-----------------------------------|---|
| 1. IPKO Telecommunications L.L.C" | 6. ELEKTRA  |
| 2. KUJTESA – NET                  | 7. DIGIT  |
| 3. EAGLE                          | 8. CABLEZONE (më 2 tetor 2008 ka njoftuar KPM-në se heq dorë nga licenca) |
| 4. TV EHO                         |   |
| 5. TELE-NET                       |   |

Pjesa tjetër e operatorëve kabllor të regjistruar në KPM, nga pamundësia të veprojnë në pajtueshmëri me rregulloren e KPM-së, kanë vendosur të shesin rrjetin e tyre, kryesisht tek dy operatorët kabllorë që kanë shtrirjen me të gjerë në Republikën e Kosovës, siç është operatori kabllor IPKO Telecommunications dhe Kujtesa.

Pos licencimit të operatorëve kabllorë është bërë edhe licencimi i 13 ofruesve të shërbimeve programore të cilëve u janë miratuar kërkesat për licencë nga Këshilli i KPM- së më 28 gusht 2008, ndërsa më 5 dhjetor 2008 të 13 ofruesit e shërbimeve programore janë pajisur me licencë të KPM-së. Ofrues të shërbimeve të licencuara nga KPM-ja gjatë vitit 2008 janë:

- |                     |                 |
|---------------------|-----------------|
| 1. On TV            | 21 Neës         |
| 2. Business Channel | 8. 21 Popullore |
| 3. Next Television  | 9. 21 Kids      |
| 4. Zero TV          | 10. Kosova MTV  |
| 5. Rrokum TV        | 11. Zico TV     |
| 6. Alsat Kosova     | 12. Zico TV 2   |
| 7. 21 Plus          |                 |

**Miratimi i rregullores për subjektet transmetuese mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve nga përmbajtjet e dëmshme programore:**

Në gjysmën e dytë të vitit 2008 u hartua rregullorja nga grupi punues i KPM-së me ekspertë të brendshëm dhe me ekspertë të jashtëm, respektivisht me një psikolog, një gjyqtare për të mitur dhe një eksperte nga organizata për të drejtat e fëmijëve – UNICEF. Drafti i fundit i kësaj rregulloreje doli për komente të publikut me 31 dhjetor 2008, kurse koha për dërgimin e komenteve ishte paraparë të zgjatë deri më 21 janar 2009, afat i cili është vazhduar sërish me qëllim që të krijohet hapësirë që në KPM të arrijnë sa më shumë komente.

Komentet me shkrim do të përcillen edhe me një dëgjim publik me media dhe me ekspertë të lëmisë së mbrojtjes dhe të drejtave të fëmijëve.

Gjatë procesit të hartimit të rregullores, KPM ka zhvilluar bisedime me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për realizimin e një fushate të përbashkët për ngritjen e vetëdijes në mesin e fëmijëve dhe publikut të gjerë, që ata të jenë të njoftuar se fëmijët dhe të miturit janë të mbrojtur nga përmbajtjet e dëmshme programore dhe që këtë mund të bëjnë duke respektuar disa parime të cilat përcaktohen me rregulloren e KPM-së.

Nxjerrja e Vendimit për tarifa për taksën për licencë për subjektet transmetuese

Përcaktimi dhe zbatimi i tarifave vjetore të licencave për subjektet transmetuese është bërë me vendimin e Këshillit të KPM-së të datës 21 korrik 2008 (i paraqitur në shtojcën x). KPM-ja ka arritur që në rregulloren për taksën për licencë, lartësinë e taksës ta kalkulojë në mënyrë që taksa të jetë adekuate për subjektet transmetuese. Tarifat janë përcaktuar duke marrë për bazë gjendjen financiare të mediave dhe kërkesën ligjore për përcaktim të tarifave të njëjta për kategori të njëjta. Me këtë vendim janë pajtuar të gjitha subjektet transmetuese. Gjatë periudhës kohore sa ka qenë i publikuar për komente nuk është pranuar asnjë koment.

Subjektet transmetuese kanë filluar pagesën e taksës në muajin gusht vetëm për periudhën 5 mujore (gusht-dhjetor 2008) dhe gjithsej janë inkasuar 57000 Euro.

**Hartimi i strategjisë për planin frekuencor digjital të Kosovës**

Në korrik 2008, Këshilli i KPM ka organizuar një takim të përbashkët me përfaqësues të industrisë mediatike kosovare, përfaqësues të OSBE-së, të IREX-it si dhe një numër ekspertësh kosovare të cilët ndanë me grupin përvojat e tyre nga ky proces. Në këtë takim janë ftuar përfaqësuesit e rregullatorit të mediave të Republikës së Maqedonisë, ish-përfaqësues të Rregullatorit të Shqipërisë dhe Sllovenisë, të cilët edhe kishin qenë pjesëmarrës në ITU gjatë procesit të planifikimit dhe koordinimit të planeve frekuencore digjitale. Ky takim ishte pikënisja e KPM-së drejt krijimit dhe adaptimit të politikës për procesin e digjitalizimit e cila duhet të përkrahë edhe nga shoqëria. Është bërë identifikimi i hapave të parë që duhet ndërmarrë në Kosovë për të nisur procesin e digjitalizimit:

- 1 Anëtarësimi i Kosovës në ITU dhe
2. Krijimi i një plani të ri digjital tokësorë për shërbime televizive që më si miri i përshtatet nevojave dhe kushteve të Kosovës.

KPM-ja do të jetë udhëheqësi i këtij procesi. Problemet që do të ndikojnë në një zhvillim të ngadalësuar të këtij procesi janë të natyrë ligjore dhe teknike. Kosova nuk është anëtare e ITU-së

dhe ajo nuk ka qenë e përfshirë në zhvillimin e planit frekuencor Gjeneva 06, i cili si i tillë është negociuar nga administrata e Serbisë dhe nuk i përshatet nevojave të Kosovës. Po ashtu mungon edhe kapaciteti teknik i stafit në kuptim të planifikimit të frekuencave digjitale dhe kryerjes së matjeve të nevojshme.

KPM përcaktoi që puna duhet filluar me krijimin e grupeve punuese në kuadër të KPM-së në muajin gusht, me studimin e përvojave nga vendet tjera për strategjitë për kalim nga sistemi analog në atë digjital në muajin nëntor dhe me organizimin e një takimi publik me përfaqësues nga institucionet relevante kosovare dhe me industrinë e mediave. KPM ka përgatitur plan-veprimin për procesin e digjitalizimit në vitin 2008, duke e përmbyllur me takimin publik të mbajtur më 19 dhjetor 2008.

Nga aspekti përgatitor teknik dhe i kapaciteteve njerëzore i KPM-së për vitin 2008, më kërkesën buxhetore për financim nga Buxheti i Kosovës, është paraqitur për miratim edhe projekti kapital për digjitalizim i cili është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në shumën prej 150,000.00 Euro.

### **Procesi i ri-licencimit të të gjitha subjekteve transmetuese**

Ky proces ka filluar në korrik 2008 kur Këshilli ka vendosur për strategjinë e lëshimit të licencave afatgjate për të përmbyllur obligimin ligjor duke përcaktuar edhe disa afate kohore për realizim.

Është vendosur që objektivi i përgjithshëm i procesit të jetë “*Normalizimi i ambientit rregullativ mediatik në Kosovë*” ndërsa principet të cilat do të udhëheqin procesin e licencimit afatgjatë të mediave në Kosovë duhet të sigurojnë që:

- Procesi duhet të jetë në përputhshmëri me planin frekuencor të Kosovës
- Procesi duhet të kontribuojë në zhvillimin afatgjatë të sektorit medial në Kosovë
- Procesi duhet të krijojë mundësi për përmbylljen e nevojave të të gjitha komuniteteve për qasje në media në gjuhën e tyre
- Procesi duhet të kontribuojë në zbatimin e politikave të transmetimit të përcaktuara në Ligjin e KPM-së

Poashtu janë përcaktuar edhe objektivat e procesit të licencimit afatgjatë:

- Objektivi 1:* Lëshimi i licencave afatgjate për mediat ekzistuese si dhe lëshimi i licencave afatgjate për transmetuesit e rinj.
- Objektivi 2:* Përcaktimi i kriterëve (kërkesave) të njëjta për të gjitha mediat, duke përfshirë kriteret profesionale teknike dhe hapësinore; kriteret kadrovike profesionale; teknike; të drejtat autoriale, financiare, programore dhe qartësimi i pronësisë dhe strukturave menaxhuese.
- Objektivi 3:* Standardizimi i procedurave dhe dokumentacionit për licencim.
- Objektivi 4:* Krijimi i planit për distribuimin e frekuencave (përfshirë edhe periudhën pas digjitalizimit) dhe përcaktimi i pikave transmetuese.
- Objektivi 5:* Krijimi i mundësisë për një transmetues publik kombëtar në gjuhët e pakicave

Raporti i strategjisë për licencimin afatgjatë iu është shpalosur mediave nga KPM-ja në një takim të përbashkët publik të mbajtur më 17 tetor 2008 në Prishtinë.

Në harmoni me strategjinë e përcaktuar, KPM ka bërë standardizimin e dokumentacionit dhe përcaktimin e procedurave për licencimin e subjekteve transmetuese. Ky proces është mbështetur nga OSBE, me ndihmën e së cilës janë kontraktuar dy ekspert të kompanisë *Albany Associates* nga

Londra, në cilësinë e konsulentëve. Dokumentet të cilat janë standardizuar, në bashkëpunim me konsulentët, janë:

1. Strategjia për licencim afatgjatë
2. Forma e aplikacionit
3. Procedurat e brendshme të licencimit
4. Pajtueshmëria me obligimet ndaj të drejtës autoriale

Procedura për licencimin afatgjatë do të fillojë me dërgimin e formave të aplikimit tek të gjitha subjektet transmetuese, ku më pas do të lëshohen edhe licencat e ndryshuara të cilat do të përmbajnë kushte dhe terme të reja. Procesi i licencimit afatgjatë të subjekteve transmetuese aktuale planifikohet të fillojë në mars të vitit 2009. Ndërsa, pas përfundimit të këtij procesi KPM do të bëjë njoftimin publik për frekuenca të lira për lokacionet në të cilat janë të disponueshme frekuencat për transmetim radio apo TV, në pajtueshmëri me planin frekuencor i cili është rishikuar gjatë vitit 2008 nga Divizioni për Menaxhim Frekuencor i KPM-së. I tërë procesi është planifikuar të përmbyllet deri në fund të vitit 2009.



# OBJEKTIVAT PËR VITIN 2009

Gjatë vitit 2009 KPM ka përcaktuar për objektiva:

## **1. Përmbyllja e procesit të rilicencimit**

*Lëshimi i licencave të ndryshuara subjekteve transmetuese aktuale dhe lëshimi i licencave të reja.*

## **2. Zbatimi i politikave të transmetimit në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtarisht.**

*KPM-ja do të bashkëpunojë dhe japë kontributin e saj në nismën e Komisionit Parlamentar për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, për rishikimin dhe amendamentimin e ligjit ekzistues për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim në përputhje me direktivën 2007/65/EC të Parlamentit dhe Këshillit të Evropës të datës 11 dhjetor 2007.*

## **3. Krijimi dhe adoptimi i politikës për procesin e digjitalizimit**

*Kompletimi i hartimit të strategjisë për digjitalizim.*

## **4. Promovimi i konkurrencës së drejtë transmetuese**

*Rishikimi dhe amendamenti i Rregullës për Reklamim.*

## **5. Licencimi i operatorëve kabllor në Veriun e Kosovës**

*KPM, me ndihmën e OSBE-së, ka arritur të krijojë një rrugë komunikimi me operatorët që veprojnë në këtë pjesë dhe gjatë vitit 2009 do të angazhohemi tutje për licencimin e tyre.*

## **6. Krijimi i parakushteve për përmbushjen e obligimit kushtetues për krijimin e një transmetuesi nacional në gjuhën serbe**

*KPM do të punojë me institucionet relevante kosovare dhe me komunitetin e medias serbe që të bëhet një planveprim për realizimin e kësaj kërkesë.*

## **7. Përforsimi i bashkëpunimit me autoritetet rregullative evropiane**

*Organizimi i konferencës EPRA 2010 në Kosovë: Komisioni i Pavarur për Media është anëtare e Platformës Evropiane të Autoriteteve Rregullative (EPRA) e cila ka gjithsej 49 anëtarë. Kjo platformë takohet në nivel ndërkombëtar dy herë në vit dhe KPM ka bërë ftesën që Konferenca e parë në vitin 2010 të organizohet në Kosovë.*

*Organizimi i një konferencë të këtij niveli në Kosovë është e një rëndësie të veçantë jo vetëm për KPM por edhe për Kosovën sepse përfaqësues nga shtete të ndryshme do të vizitojnë Kosovën dhe kjo do të ndikojë edhe për promovimin e shtetit të Kosovës edhe për përfitime financiare. KPM-ja gjatë vitit 2009 do të kryejë përgatitjet rreth organizimit të kësaj konferenceje.*

# KËSHILLI I KPM-së

### Nominimet dhe emërimet

Komisioni i Pavarur për Media ka filluar vitin 2008 pa përbërje të plotë të Këshillit të KPM-së. Këshilli i KPM-së që nga muaji gusht 2007 nuk ishte në përbërje të plotë. Në pajtueshmëri me Ligjin për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim, i cili hyri në fuqi më 8 shtator 2005, Zyra e Shefit Ekzekutiv të KPM-së ka bërë ftesën publike për nominime nga shoqëria civile më 10 prill 2007 deri më 9 maj 2007. Mirëpo, për shkak të mos paraqitjes së nominimeve nga ana e komuniteteve tjera, Zyra e Shefit Ekzekutiv të KPM-së e ka vazhduar afatin e procesit të nominimit edhe për dy javë deri më 29 maj 2007 dhe ka bërë publike listën e të nominuarve nga afati i parë. Pas përfundimit të afatit të dytë më 29 maj 2007. Shefi Ekzekutiv i ka dërguar nominimet në Kuvendin e Kosovës më 14 qershor 2007.

Në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 14 mars 2008, me shumicë votash u emëruan dy anëtarët e rinj të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media. z. Daut Demaku dhe znj. Argjentina Grazhdani.

Pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës është paraqitur nevoja që të bëhet zëvendësimi i anëtarëve ndërkombëtarë me anëtarë vendorë dhe të njëjtën kohë është paraqitur nevoja që për të plotësuar dy pozita në Këshill të cilat do të liroheshin më 28 gusht 2008, pas përfundimit të mandatit dyvjeçar të dy anëtarëve nga shoqëria civile.

Zyra e shefit Ekzekutiv filloi procesin e nominimeve nga shoqëria civile më 10 prill 2008 me publikimin e një ftesë për të gjithë personat dhe organizatat e regjistruara ligjërisht që të parashtrajnë nominimet për Këshillin e KPM-së. Kjo ftesë publike është bërë përmes njoftimit në të gjitha gazetatat, në uef faqen e KPM-së si dhe në mediat elektronike. Pas periudhës 30 ditësh deri më 9 maj, zyra e shefit ekzekutiv ka pranuar 14 nominime. Pasi që në mesin e tyre nuk ka pasur numër të mjaftueshëm të nominimeve nga ana e minoriteteve, zyra e shefit ekzekutiv të KPM-së ka vazhduar afatin edhe për dy javë në mënyrë që të silltet në pajtueshmëri me kërkesat ligjore që Këshilli të reflektojë shoqërinë multietnik në Kosovë.

Afati i dytë ka përfunduar më 29 maj 2008 dhe ka rezultuar me dy (2) nominime të reja që ka sjell numrin e përgjithshëm në 16. Sipas Ligjit të KPM-së, Zyra e Shefit Ekzekutiv obligohet që t'i dërgojë Komisionit Ad Hoc të Kuvendit të Republikës së Kosovës një listë me emrat e tetë të nominuarve më të kualifikuar për të katër pozitat që duhet të plotësohen në Këshillin e KPM-së në muajin gusht 2008. KPM ka vlerësuar që numri i nominimeve të arritura nuk ka qenë i mjaftueshëm për të bërë zgjedhjen e 8 më të kualifikuarve, prandaj ka vazhduar ftesën për nominime edhe për dy javë të tjera duke përsëritur ftesën për nominime tek shoqëria civile që të sjellin nominime të reja për anëtarë të Këshillit të KPM-së. Afati i tretë dhe përfundimtarë ishte prej 4 qershor deri më 19 qershor 2008. Gjatë tri afateve janë nominuar gjithsejtë 19 persona për Këshillin e KPM-së. Pas çdo afati, KPM ka publikuar emrat dhe ka kërkuar komente nga Publiku. KPM nuk ka pranuar asnjë koment lidhur me të nominuarit. Një prej të nominuarve ka tërhequr nominimin e vet më 2 korrik 2008 kështu që KPM ka shqyrtuar gjithsej 18 nominime.

Obligimin ligjor Zyra e Shefit Ekzekutiv e ka përmbush me 7 korrik 2008, kur përfundimisht tetë nominime u përcjellën në Kuvend për procedim të mëtejshëm deri në emërim, mirëpo vonesat në këtë drejtim brenda Kuvendit nuk sollën katër anëtarët e rinj në Këshill deri më 15 dhjetor 2008, duke

lënë Këshillin e KPM-së në situatë joaktive për 4 muaj. Kuvendi i Kosovës me 15 dhjetor ka emëruar 4 anëtarë Filloretë Bytyçi, Sadije Nikshiqi, Agim Sopi dhe Ramë Bajraktari anëtarë të rinjë të Këshillit të KPM-së.

Në Këshillin e KPM-së ende pritet që të emërohet anëtari i shtatë (7), i nominuar dhe emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

## **TAKIMET DHE VENDIMET E KËSHILLIT TË KOMISIONIT TË PAVARUR PËR MEDIA GJATË VITIT 2008**

Gjatë vitit 2008, janë mbajtur gjithsej shtatë (7) takime të Këshillit të KPM-së, gjatë së cilave ka shqyrtuar dhe ka marrë vendime për rastet e paraqitura më poshtë:

- **Zgjedhja e kryetarit të Këshillit të KPM-së;**

*Pas konstituimit të Këshillit me përbërje të plotë është bërë zgjedhja e Kryetares së Këshillit. Në periudhën 7 mujore pa Këshill të kompletuar, Këshilli është prezantuar nga Zëvendës Kryetari.*

- **Miratimi i vendimit për taksën për licencë për subjektet transmetuese;**

*Pasi Bordi i Ankesave për Media kishte kthyer për shqyrtim vendimin e parë të Këshillit të miratuar në prill 2007, Këshilli i KPM-së hartoi vendimin e ri I cili u pranua nga të gjitha subjektet transmetuese.*

- **Vendimi për vërejtje të RTK-së për dështimin e mbulueshmërisë të Seancës së Kuvendit në mënyrë adekuate, siç parashihet me Ligjin për RTK-në;**

*RTK kishte transmetuar ndeshje futbolistike dhe nuk i kishte dhënë mbulueshmërinë adekuate, siç kërkohet me ligj, transmetimit të seancës së Kuvendit gjatë së cilës ishin miratuar dhjetë ligjet e fundit nga Pakoja e Ahtisaarit.*

- **Miratimi i Raportit për Mediat gjatë zgjedhjeve në Kosovë;**

*Gjatë fushatës zgjedhore, roli i KPM-së ka qenë që të nxjerrë udhëzues për implementim të Rregullës Zgjedhore për Media të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të shqyrtojë ankesat që janë përcjellur nga Komisioni Qendror Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa. Në përfundim të fushatës është përpiluar një raport përmbledhës për mediat gjatë zgjedhjeve i cili është miratuar nga Këshilli .*

- **Vendimi për Licencimin e 10 Operatorëve Kabllorë për bartjen e programeve televizive për të cilat kanë siguruar të drejtën për transmetim;**

*Pas hyrjes në fuqi të Rregullores së KPM-së për operatorët kabllorë në fund të vitit 2007, në maj është vendosur që të licencohen 10 operatorë kabllorë të cilët kishin arritur të aplikojnë në pajtim me kushtet e përcaktuara në rregullore*

- **Miratimi i ndryshimit të licencës së TV Pulsit duke reflektuar ndërrimin e pronarit;**

*Pronësia është ndryshuar nga nëna tek i biri. Skema programore ka mbet e pandryshuar.*

- **Vendim për Autorizimin e zyrës së SHE për Implementimin e Vendimi të Këshillit të KPM-së për konfiskim të pajisjeve;**

*Pas revokimit të licencës me vendim të këshillit të KPM-së, radio Zëri i Sharrit ka marrë statusin e radio stacionit ilegal dhe me vendimin autorizues të Këshillit Zyra ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për konfiskim të pajisjeve, siç parashihet me Nenin 20.5 të Ligjit të KPM-së për operimet ilegale.*

- **Vendimi për Licencimin e 13 Ofrueseve të Shërbimeve Programore;**

*Me rregulloren e Këshillit CIMC 2007/04 për operimet në rrjetin kabllor, është mundësuar edhe veprimtaria e ofruesve të shërbimeve programore të cilët KPM i licencon dhe i rregullon njëjtë si subjektet transmetuese.*

- **Vendimi për Hapjen e Tenderit për Televizion Lokal në Mitrovicë dhe vendimi për Licencim të TV Mitrovicës deri në afatin e rilicencimit;**

*Për shkak të mungesës së një mediumi televiziv në gjuhën shqipe në komunën e Mitrovicës, Këshilli vendosi që të hap procesin e konkurrimit për një frekuencë televizive. Pas shpalljes së tenderit dy herë radhazi, Këshilli i KPM-së ka licencuar OJQ Mitrovica që të veprojë si TV stacion lokal në komunën e Mitrovicës.*

- **Vendimi i Këshillit për ftesë publike për anëtarin e Bordit të Ankesave për Media;**

*Me qëllim të zëvendësimit të anëtarit ndërkombëtar të BAM-it më anëtar vendor, KPM ka filluar procedurën e nominimit dhe ftesa bëhet nga Këshilli, sipas Ligjit të KPM-së.*

- **Vendimi i Këshillit për gjobë të suspenduar për Operatorët Kabllorë të gjetur në shkelje të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme për Licencë;**

*Operatorëve kabllorë që ishin në shkelje të kushteve dhe termeve të licencës u janë lëshuar vendime me gjobë të suspenduar me qëllim të përmirësimit.*

- **Vendimi mbi Delegimin e Përgjegjësiave tek Zyra e Shefit Ekzekutiv të KPM-së;**

*Me rregullat e procedurës së punës së këshillit të KPM-së, Këshilli mund të delegojë detyra tek Zyra e Shefit Ekzekutiv dhe këto vendime mund t'i rishikojë çdo vit.*

- **Miratimi i Draft Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore;**

*Drafti është publikuar për komente publike.*

- **Vendimi i Këshilli për ndryshim të pronësisë së Radio “Fontana”**

*Pronësia ka kaluar tek kryeredaktori i stacionit, i cili me punën e vet ka arritur të sjellë ndryshime në të mirë të audiencës dhe ky ndryshim nuk do të ndikojë në ndryshimin e formatit të programit dhe zonës së mbulueshmërisë;*

- **Vendimi i Këshilli për gjobitje për shkeljet e Kushteve të Përgjithshme të Licencës të Operatorit Kabllor “Eagle”, në Prizren dhe Operatorit Kabllor “Telenet” në Pejë**

*Për shkak të ritransmetimit të një numri të konsiderueshëm të kanaleve televizive pa kontrata, që paraqet shkelje të kushteve të licencës janë lëshuar dënime sanksionuese me gjoba prej 20,000.00 Euro, respektivisht 10,000.00 Euro.*

# ORGANIZIMI I TAKIMEVE PUBLIKE

Komisioni i Pavarur për Media ka organizuar tri takime publike në lidhje me:

1. *Strategjinë për licencimin afatgjatë*
2. *Krijimin e një kanali mbarëkosovar në gjuhën serbe, dhe*
3. *Hartimin e strategjisë për digjitalizim*

## I. STRATEGJIA PËR LICENCIMIN AFATGJATË

Më 17 tetor 2008, pas hartimit të planveprimit për procesin e licencimit, Komisioni i Pavarur për Media ka ftuar në një takim të përbashkët publik subjektet transmetuese të licencuara dhe përfaqësues të asosiacioneve dhe organizatave mediale për të shpalosur planin për procesin e licencimit afatgjatë dhe për të marrë qëndrimet e mediave në lidhje me këtë proces.

KPM ka kërkuar që mediat të shqyrtojnë dhe analizojnë planin strategjik për licencimin afatgjatë dhe të ofrojnë komentet e tyre në KPM. Pjesëmarrësit janë njoftuar se me këtë strategji për licencimin afatgjatë të mediave në Kosovë Komisioni i Pavarur për Media synon që:

- të stabilizojë dhe të standardizojë sektorin medial;
- licencat e reja të jenë në përputhshmëri me planin frekuencor të Kosovës;
- të kontribuojë në zhvillimin afatgjatë të sektorit medial në Kosovë;
- të krijojë mundësi për përmbushjen e nevojave të të gjitha komuniteteve për qasje në media në gjuhën e tyre, si dhe
- të kontribuojë në zbatimin e politikave të transmetimit të përcaktuara në Ligjin e KPM-së.

## II. KRIJIMI I NJË KANALI MBARËKOSOVAR NË GJUHËN SERBE

Këshilli i KPM-së më 25 nëntor 2008, ka organizuar edhe takimin tjetër publik me temën “Krijimi i një kanali mbarëkosovar në gjuhën serbe – sfidat dhe mundësitë”. Bazuar në Kushtetutën e Kosovës dhe në Planin e Ahtisaarit për Kosovën parashihet që “Kosova duhet të ndërmarrë të gjitha masat e duhura që të sigurojë një plan ndërkombëtar të frekuencave për t’i lejuar komunitetit serb qasje në një kanal televiziv të pavarur mbarë kosovar në gjuhën serbe.” Andaj, Komisioni i Pavarur për Media ka hapur diskutimin publik për të trajtuar këtë çështje, me qëllim të gjetjes së mënyrës më të mirë të mundshme dhe të përshtatshme, për të realizuar krijimin e një kanali kombëtar në gjuhën e komuniteteve. Në takim kanë marrë pjesë përfaqësues të qeverisë, të mediave kombëtare e lokale, të minoriteteve dhe institucioneve ndërkombëtare në Kosovë, asociacioni i gazetareve serb të Kosovës, përfaqësues nga Fondi Për të Drejtën Humanitare etj. Pjesëmarrësit e kanë përshëndetur nismën e KPM-së për nevojën e debatit rreth modelitave dhe formës së krijimit të kanalit serb televiziv me shtrirje kombëtare në Kosovë.

Nga KPM është sqaruar se me Pakon e Ahtisaarit dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, institucionet e Kosovës e kanë marrë përgjegjësinë për të parë mundësitë e krijimit të një kanali gjithëkombëtar në gjuhën serbe. Përfaqësuesi i Kryeministrit të Qeverisë së Kosovës ka deklaruar se ekzekutivi kosovar do ta mbështesë themelimin e kanalit televiziv për minoritetin serb që jeton në Kosovë, ashtu siç parashihet me Planin e Ahtisaarit, ndërsa Përfaqësuesi i Ministrisë për Kthim dhe Komunitete ka insistuar që të merret parasysh niveli i një sigurie që kanali televiziv për komunitetin serb dhe politika editoriale e atij kanali të mos jetë e ndikuar politikisht, por të krijohen kushtet që të ketë pavarësi të plotë.

KPM ka bërë edhe prezantim të situatës mediale të fokusuar në subjektet transmetuese minoritare serbe, respektivisht në numrin e tyre të licencuar dhe të dhëna për mbulueshmërinë aktuale që rezulton të jetë në nivel të knaqshëm. Pastaj janë prezantuar dy projekt propozime nga dy organizatat ndërkombëtarë, IREX dhe UNDP, për idetë e tyre për themelimin e kanalit televiziv për komunitetin serb në Kosovë:

1. Projekt propozimi i organizatës IREX parasheh krijimin e një rrjeti duke i lidhur 4 kanalet televizive ekzistuese lokale serbe (TV Herc, TV Puls, TV Most dhe TV Mir) përmes sistemit VPN të internetit (virtual private network) në mënyrë që këto televizione të shkëmbejnë programet e tyre, ndërsa qendra e sistemit dhe e mbledhjes së informatave të vendoset në Media Center – Çagllavicë.
2. Projekt propozimi i prezantuar nga UNDP parasheh krijimin e kanalit të dytë televiziv në kuadër të transmetuesit publik RTK, në mënyrë që sinjali i këtij kanali televiziv të mbulojë tërë territorin e Kosovës.

Përfaqësuesit e asociacioneve të gazetarëve dhe të mediave lokale serbe e kundërshtuan mundësinë për krijimin e kanalit serb si kanal i dytë i RTK-së. Ata kërkuan që të bashkëpunohet më shumë me asociacionet dhe grupet e gazetarëve serbë të Kosovës për t'u përcaktuar në zgjidhjen më të mirë për krijimin e kanalit televiziv për komunitetin serb. Pjesëmarrësit kanë rekomanduar që të zhvillohet debati mbi këtë çështje, në mënyrë që të gjitha palët e përfshira të paraqesin qëndrimet e veta dhe të ketë një harmonizim mes dallimeve të shprehura në takim.

Ky takim ka prezantuar një nismë të mirë të KPM-së për përmbushjen e kërkesës kushtetuese dhe të planit gjithpërfshirës të Ahtisaarit ndërsa konkluzë e takimit ishte vazhdimi i këtij debati edhe me takime tjera me qëllim të marrjes së vendimit më të drejtë të mundshëm.

### **III. HARTIMI I STRATEGJISË PËR DIGJITALIZIM NË KOSOVË**

Më 19 dhjetor 2008 Komisioni i Pavarur për Media ka organizuar takimin e tretë publik me temën “Kosova dhe e ardhmja digjitale e transmetimeve.” Në takim u diskutua për nevojën e hartimit të një strategjie që do të përcaktonte edhe Kosovën si pjesë të familjes digjitale të transmetimeve dhe si anëtare e Unionit ndërkombëtarë të Transmetimit (ITU).

Përveç zyrtarëve më të lartë të KPM-së, në takim morën pjesë edhe drejtuesit e mediave kombëtare të Kosovës, Qeverisë së Kosovës, përfaqësues të mediave të licencuara, të KTTN-së, ART-së, AMPEK-ut, studiues dhe ekspertë të telekomunikacionit dhe përfaqësues nga organizatat ndërkombëtare OSBE, ICO dhe IREX.

Në këtë takim, Komisioni i Pavarur për Media paraqiti planin frekuencor digjital të përcaktuar nga ITU për transmetimet tokësore digjitale së bashku me rezultatet e një studimi të bërë në lidhje me politikën dhe strategjitë zhvillimore të transmetimit, sfidat gjatë fazës së kalimit nga sistemi analog në atë digjital të transmetimeve në vendet e rajonit dhe Bashkimit Evropian (12 gjithsej). Prezantimet janë bërë nga KPM dhe nga dy ekspertë të jashtëm (nga Mqedonia dhe Shqipëria). Fillimi i procesit të digjitalizimit është mbështetur nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Transportit dhe Postë-Tekekomunikacionit të cilat kanë treguar gatishmërinë e tyre për të qenë pjesë e grupeve punuese të cilat do të fokusohen në çështje teknike, ligjore, ekonomike dhe të informacionit. Afati kohor për hartimin e strategjisë dhe paraqitjen e draftit të parë është përcaktuar nga Këshilli i KPM-së për muajin qershor 2009.

## ZYRA E SHEFIT EKZEKUTIV

E udhëhequr nga Shefi Ekzekutiv, Zyra vepron si sekretariat për Këshillin dhe Bordin e Ankesave të Mediave në të njëjtën kohë sa edhe ekzekuton vendimet dhe politikat e përcaktuara nga Këshilli. Për vitin 2008 nga MEF dhe MSHP ishin të miratur 24 punëtorë, mirëpo për shkak të lëvizjeve të punëtorëve për shkaqet tashmë të cekura, Zyra nuk ka arrit të plotësojë numrin e kërkuar. Struktura organizative e Zyrës është trashëguar nga paraardhësi ligjor KPM i cili ka vepruar në një realitet ndryshe dhe për Shefin Ekzekutiv ky fakt ka paraqitur probleme në funksionalitet. Deri në vitin 2008 Zyra ka punuar vetëm me subjektet transmetuese dhe tërë rregullimi ka qenë i fokusuar në atë drejtim. Me licencimin e operatorëve kabllorë dhe ofruesve të shërbimeve programore dhe me përcaktimin e Këshillit për strategjinë për digjitalizim, ka lind nevoja që stafi të shtohet në numër dhe të ndryshojë edhe struktura.

Për këtë qëllim është bërë rishikimi funksional i Zyrës së Shefit Ekzekutiv nga një ekspert vendor i cili ka rekomanduar që duhet ndryshuar strukturën organizative dhe disa nga procedurat e brendshme për funksionim.

Gjatë vitit 2008, Zyra e Shefit Ekzekutiv ka funksionuar me një strukturë organizative me katër divizione kyçe (Divizioni Ligjor, i Licencimit, Monitorimit dhe Pajtueshmërisë së Mediave dhe Divizioni për Menaxhim të Frekuencave) që përbëjnë departamentin e Rregullimit të Transmetimit dhe me Departamentin e Administratës.

Në vitin 2009, KPM do të ketë 31 të punësuar dhe do të funksionojë me një strukturë të re organizative.




Fig. 1 Skema e re organizative e Zyrës së Shefit Ekzekutiv e aplikueshme nga 2009

# PUNA E PREZANTUAR SIPAS STRUKTURËS

## DEPARTAMENTI I RREGULLIMIT TË TRANSMETIMIT

### *Divizioni i Monitorimit*

Me licencimin e shërbimeve të reja audiovizuale, monitorimi është fokusuar në tri kategori transmetimi:

- në atë të subjekteve transmetuese lineare (radio dhe TV)
- në operatorë kabllorë, dhe
- në ofrues të shërbimeve programore përmes kablllos

Kjo ka ndikuar që gjatë vitit 2008, të shtohet dukshëm vëllimi i punëve të Divizioni i Monitorimit dhe Pajtuëshmërisë së Mediave (DMPM).

Duke shfrytëzuar infrastrukturën e subjekteve transmetuese jo-lineare (operatorëve kabllor) DMPM-ja ka arritur që në masë të madhe të përmbush objektivat e saja të parapara për këtë vit për faktin që në këtë rrjet janë bartur edhe sinjalet e TV stacioneve lokale në të cilat KPM nuk ka pasur qasje më parë për të bërë monitorimet dhe incizimet e veta.

Monitorimi i pajtuëshmërisë me Rregullën për Reklamim, monitorimet dhe analizat e përmbajtjeve programore, pajtuëshmëria e subjekteve transmetuese me të drejtën e autorit si dhe monitorimet e operatorëve kabllorë dhe ofruesve të shërbimeve programore përmes kablllos ishin projektet kryesore të realizuara gjatë këtij viti nga ky divizion.

Gjetjet dhe rekomandimet e këtij divizioni pas realizimit të projekteve të lartpërmendura, ishin bazë mbi të cilat Divizionet tjera kanë mbështetur veprimet e tyre, sidomos Divizionit Ligjor i cili ka proceduar me disa raste deri në rekomandime për sanksione. Gjithashtu ato i ofrojnë KPM-së një pasqyrë më të saktë për performancën e subjekteve transmetuese në prag të procesit të licencimit afatgjatë.

Sfidë kryesore për këtë divizion në vitin 2008 ishte identifikimi i operatorëve kabllorë të cilët veprojnë ilegalisht, të cilët pastaj janë udhëzuar që të aplikojnë në KPM për licencë.

Pas licencimit të operatorëve kabllor nga KPM-ja, janë bërë edhe shumë vizita, inspektime e monitorime nga stafi monitorues.

Gjatë këtij viti, Divizioni i Monitorimit ka filluar me monitorimin e programeve që ritransmetohen nga këta operatorë me qëllim të verifikimit të pajtuëshmërisë së tyre me kushtet dhe termet e përgjithshme të licencës së tyre, si dhe janë vizituar/monitoruar edhe 8 operatorë ilegal kabllor. Sqarimet e dhëna nga personeli i Divizionit për Monitorim dhe Pajtuëshmëri tek operatorët kabllorë ilegalë ka rezultuar me ardhjen e tyre në KPM me ç'rast kanë aplikuar për licencë.

DMPM-ja gjithashtu ka vizituar edhe 13 Ofrues të Shërbimeve Programore përmes kablllos (ON TV, Kosova MTV, Rrokum TV, Business Channel, Zico TV, Zico TV 2, Alsat Kosova, Next Television, Zero TV, 21 Plus, 21 Popullore, 21 Kids dhe 21 Neës).

Këto vizita dhe inspektime ishin rast i mirë që monitoruesit të vëjnë kontaktet e para dhe njoftohen më për së afërmi me punën e ofruesve të shërbimeve programore përmes kabllorëve.



Po ashtu në vazhdimësi janë monitoruar televizionet lokale, lidhur me pajtueshmërinë me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, respektivisht respektimi i të drejtës së autorit, ndërsa gjetjet nga këto monitorime dhe rekomandimet për shkeljet e mundshme i janë përcjell Divizionit Ligjor të KPM-së për të proceduar më tutje.

Në vazhden e përpjekjeve që Zyra e Komisionit të Pavarur për Media po i bënë për avancimin dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit të sajë, stafi i Divizioni i Monitorimit dhe Pajtueshmërisë së Mediave i KPM-së nga 13 deri më 17 nëntor 2008, ka vijuar trajnimin me temën Monitorimi i përmbajtjes së programeve të mediave elektronike. Trajnues ishin ligjërues me përvojë në fushën e komunikimit medial dhe ekspert të monitorimit të mediave elektronike nga “Instituti për Demokraci dhe Zhvillim”, me seli në Shkup si dhe Këshilli Radiodifuziv i Maqedonisë.

Trajnimi kishte për qëllim që Divizioni i Monitorimit të njoftohet dhe të identifikojë më lehtë zhanret gazetareske, politikat editoriale si dhe të përfitojë shkathtësitë dhe njohurit përkatëse për mënyrën më të mirë të monitorimit të mediave elektronike dhe analizës së performancës së tyre. Theks i veçantë gjatë këtij trajnimi iu kushtua monitorimit të mediave elektronike gjatë zgjedhjeve.

### **Divizioni i Licencimit**

Gjatë vitit 2008, ka filluar të implementohet rregullorja Distribuimin Kabllor të Programeve Radio Televizive, ku nga 16 operatorë kabllorë të regjistruar gjatë vitit 2007, vetëm 10 operatorë kabllor kanë arritur t’i plotësojnë kushtet për t’u pajisur me licencë të KPM-së. Këshilli i KPM-së lëshoi vendim për licencimin e 10 operatorëve kabllor, ndërsa vetëm 8 janë pajisur me licencë të KPM-së pasi që 2 operator kabllor për të cilët ishte marrë vendim për licencim, në ndërkohë e kanë shitur rrjetin e tyre kabllor. Ndërsa, pas 5 muajsh, një operator kabllor i licencuar ka njoftuar KPM-së se heq dorë nga licenca për shkak se e ka shitur rrjetin e tij kabllor. Gjithashtu edhe pjesa tjetër e operatorëve kabllor të regjistruar në KPM, nga pamundësia të veprojnë në pajtueshmëri me rregulloren e KPM-së, kanë vendosur të shesin rrjetin e tyre, kryesisht tek dy operatorët kabllorë që kanë shtrirjen me të gjerë në Republikën e Kosovës, siç është operatori kabllor IPKO Telecommunications dhe Kujtesa. Kështu që, gjatë vitit 2008 kanë vazhduar punën 7 operator kabllor të licencuar.

Në bazë të nenit 16, të rregullores për Distribuimin Kabllor të Programeve Radio Televizive, KPM ka krijuar mundësin që të licencojë edhe ofrues të shërbimeve programore, të cilët mund të shpërndajnë përmbajtjen e tyre programore vetëm përmes rrjetit kabllor, që nënkupton transmetim jo-linear. Pra, për këtë lloj transmetimin nuk parashihet të shfrytëzohen resurse nga spektri frekuencor, mirëpo aspekti rregullativ do të jetë njësoj, sikurse ndaj subjekteve transmetuese të cilat shfrytëzojnë frekuenca.

Gjatë vitit 2008, Divizioni i Licencimit fillimisht ka pranuar 13 kërkesa për licencë për të vepruar si ofrues të shërbimeve programore. Të gjitha kërkesat janë miratuar nga Këshilli i KPM-së, kështu që 13 ofrues të shërbimeve programore janë pajisur me licencë të KPM-së. Në Divizionin e Licencimit janë paraqitur edhe 7 kërkesa për licencë për ofrues të shërbimeve programore, të cilat janë në fazën e procesit të vlerësimit.

Para se të fillohet me licencimin e transmetimit jo-linear, Divizioni i Licencimit ka kontaktuar autoritetet rregullative të mediave në rajon (Shqipëri, Maqedoni, Mali i Zi dhe Bosnje e Hercegovinë) lidhur me rregullimin dhe licencimin e transmetimit jo-linear, me qëllim të analizimit dhe krahasimit të mënyrës së rregullimit për këtë lloj transmetimi. Përfundimisht, KPM është në avantazh lidhur me zhvillimin e transmetimit jo-linear, në relacion me vendet tjera të rajonit.

Këshilli i Komisionit të Pavarur për Media, në takimin e mbajtur më 7 shkurt 2008 mori vendim të shpallë të lirë një frekuencë për TV stacion lokal në Mitrovicë, duke marrë parasysh rëndësinë e sigurimit të një mundësie për qytetarët e Mitrovicës që të kenë qasje në informim televiziv në gjuhën shqipe, dhe me qëllim që të mos ketë zbrazëti të informimit televiziv të qytetarëve të kësaj komune.

Pas njoftimit publik lidhur me tenderimin e frekuencës për TV lokale në Mitrovicë, në KPM janë paraqitur 6 kandidatë të interesuar, aplikacionet e të cilëve janë proceduar dhe vlerësuar nga Divizioni i Licencimit. Në Takimin e Këshillit të KPM-së, të mbajtur më 9 maj 2008, është marrë vendim që të gjithë kandidatët të diskualifikohen për shkak se asnjëri prej tyre nuk kishte ofruar të dhëna mbi qëndrueshmërinë financiare. Gjatë afatit të rishpallur, Divizioni i Licencimit ka pranuar 4 aplikacione, ku 3 prej tyre ishin të përgjegjshme dhe i plotësonin të gjitha kriteret, ndërsa në bazë të kriterëve për vlerësim, Këshilli i KPM-së vendos që licenca përkohësisht t'i lëshohet kandidatit OJQ "Mitrovica", deri në fazën licencimit afatgjatë.

Gjatë vitit 2008, Divizioni i Licencimit ka pranuar kërkesa dhe ankesa të ndryshme nga bartësit e licencave, dhe personave tjerë të interesuar për të ushtruar veprimtari në media elektronike – radio apo TV. Gjithashtu, janë iniciuar edhe raste ex-officio kur është vërejtur shkelje e kushteve dhe termeve të licencës nga ana e subjekteve transmetuese. Në Divizionin e Licencimit, gjatë vitit 2008, janë paraqitur gjithsej 29 raste të natyrave të ndryshme ku 21 kishin të bënin me shkelje të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së, ndërsa 8 ishin kërkesa për frekuenca të lira – radio TV.

Nga rastet e vitit 2007, për vitin 2008 në Divizionin e Licencimit janë bartur dy raste të cilat në bazë të respektimit të procedurave konsiderohen të përfunduara dhe të mbyllura nga Divizioni i Licencimit. Rast më specifik që është bartur nga viti 2007 ka mbetur rasti i Radio Globit. Më 27 tetor 2008, Divizioni i Licencimit dhe përfaqësues të divizioneve tjera të KPM-së, janë takuar me pronarin e Radio Globit për të ofruar zgjidhjen më të mirë të mundshme që ky subjekt transmetues të fillojë transmetimin.

Mundësia e vetme për të zgjidhur problemin e Radio Globit, i cili kishte ndërhyrje nga disa subjekte transmetuese që transmetonin edhe jashtë territorit të Republikës së Kosovës, ishte ndërrimi i frekuencës. Këtë propozim e pranoi edhe pronari i Radio Globit, mirëpo për të filluar me transmetim të programit, pronari i Radio Globit kërkoi një periudhë kohore deri në rikonsolidimin e radio stacionit, pasi që nga qershori i vitit 2007, ky subjekt transmetues e kishte ndërprerë transmetimin. Më 4 nëntor 2008, Radio Globi e ka njoftuar KPM-në për planin e veprimit dhe progresin e bërë drejt rikonsolidimit të radio stacionit, megjithatë edhe gjatë vitit 2008 nuk ka arritur të fillojë me transmetimin e programit.

Të gjitha rastet e paraqitura në Divizionin e Licencimit të Zyrës së Komisionit të Pavarur për Media janë shqyrtuar në bazë të rregullave dhe rregulloreve si dhe akteve tjera juridike që janë në pajtueshmëri me Ligjin për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim. Të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me çështje të licencimit janë të publikuara në ueb faqen e KPM-së [eëë.imc-ko.org](http://eëë.imc-ko.org)

### **Divizioni ligjor**

Ky divizion gjatë vitit 2008 ka shqyrtuar raste të natyrave të ndryshme të subjekteve transmetuese dhe operatorëve kabllorë për shkelje të ligjit të KPM-së dhe akteve nënligjore të KPM-së. Varësisht nga natyra e shkeljes së dispozitave ligjore të KPM-së rastet e proceduara janë kategorizuar dhe paraqitur si në vijim:

## **Shkelja e Ligjit të KPM-së.**

### *Rastet për transmetim pa licencë-transmetim ilegal*

Gjatë vitit 2008, janë proceduar 13 raste për shkeljen e Nenit 11.1, Ligjit të KPM-së. i cili përcakton se: *“Për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij Ligji kërkohet licenca për trasnemt看 të cilin e lëshon Komisioni”*, dhe Neni 20.5 i Ligjit të KPM-së, i cili përcakton se: *“Kushdo që operon pa leje transmetimi valide, i konfiskohet aparatura perkatëse për transmetim. Subjekti i tillë nuk mund të ankohet tek Bordi i Ankesave për Media”*.

Rastet e proceduara për shkeljen e dispozitave të lartë përmenduar janë:

1. Do Progres - Ofrues i shërbimeve kabllore. I është dërguar Njoftim për Shkleje, rasti bartet për procedim të mëtejshëm në vitin 2009.
2. Dream Cable TV System - Ofrues i shërbimeve kabllore, i është dërguar Njoftim për Shkleje, rasti konsiderohet i mbyllur-përfunduar, ka rënë në pajtueshmeri me dispozitat ligjore të KPM-së.
3. KDS-LINK - Ofrues i shërbimeve kabllore, i është dërguar Njoftim për Shkleje, rasti bartet për procedim të mëtejshëm në vitin 2009.
4. N.P.SH. Visa Elektro - Ofrues i shërbimeve kabllore, i është dërguar Njoftim për Shkleje, rasti konsiderohet i mbyllur-përfunduar, ka rënë në pajtueshmeri me dispozitat ligjore të KPM-së.
5. N.R. Galla SH.P.K - Ofrues i shërbimeve kabllore, i është dërguar Njoftim për Shkelje, rasti konsiderohet i mbyllur - përfunduar, ka rënë në pajtueshmeri me dispozitat ligjore te KPM-së.
6. N.SH. Al Cable TV - Ofrues i shërbimeve kabllore, i është dërguar Njoftim për Shkleje, rasti konsiderohet i mbyllur - përfunduar, ka rënë në pajtueshmeri me dispozitat ligjore të KPM-së.
7. K.D.S –VGN - Ofrues i shërbimeve kabllore, i është dërguar Njoftim për Shkleje, rasti bartet për procedim të mëtejshëm në vitin 2009.
8. Cable TV - Ofrues i shërbimeve kabllore, i është dërguar Njoftim për Shkleje, rasti bartet për procedim të mëtejshëm në vitin 2009.
9. Cable TV - Ranilluk, Ofrues i shërbimeve kabllore, i është dërguar Njoftim për Shkleje, rasti bartet për procedim të mëtejshëm në vitin 2009.
10. TV Net – Ofrues i Shërbimeve Programore, i është dërguar Njoftim për Shkleje, rasti konsiderohet i mbyllur - përfunduar, ka rënë në pajtueshmëri me dispozitat ligjore të KPM-së.
11. Intersat - Ofrues i shërbimeve kabllore, i është dërguar Njoftim për Shkleje, rasti konsiderohet i mbyllur - përfunduar, ka rënë në pajtueshmeri me dispozitat ligjore te KPM-së.

12. Trio Trade - Ofrues i shërbimeve kabllore, i është dërguar Njoftim për Shkelje, ka rënë në pajtueshmëri me dispozitat ligjore të KPM-së
13. DIGIT - Ofrues i shërbimeve kabllore, i është dërguar Njoftim për Shkelje, ka rënë në pajtueshmëri me dispozitat ligjore të KPM-së

### **Shkelja e Rregullës për Reklamim 2007/06**

Divizioni Ligjor gjatë vitit 2008 ka proceduar nëntë (9) raste për shkelje të rregullës për reklamim:

1. TV 21 - Televizion Nacioanl, ka bërë shkelje të Nenit 12.1 të Rregullës për Reklamim për Subjektet Transmetues CIMC-2007/06, por pas pranimit të njoftimit për shkelje, ka arritur të jetë në pajtueshmëri me Rregullën në fjalë.
2. Radio Televizioni i Kosovës - RTK, Televizion Publik, ka bërë shkelje të Rregullës për Reklamim për Subjektet Transmetues CIMC-2007/06. Përkundër faktit që i është dërguar Njoftimi për Shkelje pala ka dështuar të jetë në pajtueshmëri me Nenin 10.3 pika b dhe d të Rregullës për Reklamim, si rezultat i dështimit për t'u sjellë në pajtueshmëri me rregullën në fjalë, pala është sanksionuar me dënim me gjobë në shumë prej 2,000.00 Euro për shkeljen e bërë.
3. TV Syri Vizion - Televizion Lokal ka bërë shkelje të Nenit 2. të Rregullës për Reklamim për Subjektet Transmetues CIMC-2007/06, por pas pranimit të njoftimit për shkelje ka arritur të jetë në pajtueshmëri me Rregullën në fjalë.
4. TV Opinioni - Televizion Lokal, ka bërë shkelje të Nenit 11.1 të Rregullës për Reklamim për Subjektet Transmetues CIMC-2007/06, palës i është dërguar njoftimit për shkelje, rasti është i hapur - bartet për procedim të mëtejshëm në vitin 2009.
5. TV Besa - Televizion Lokal, ka bërë shkelje të Nenit 11.1 të Rregullës për Reklamim për Subjektet Transmetues CIMC-2007/06, palës i është dërguar njoftimit për shkelje, rasti është i hapur - bartet për procedim të mëtejshëm në vitin 2009.
6. TV Liria -Televizion Lokal, ka bërë shkelje të Nenit 2. të Rregullës për Reklamim për Subjektet Transmetues CIMC-2007/06, por pas pranimit të njoftimit për shkelje ka arritur të jetë në pajtueshmëri me Rregullën në fjalë.
6. KTV - Televizion Nacional, ka bërë shkelje të Nenit 10.3. të Rregullës për Reklamim për Subjektet Transmetues CIMC-2007/06, por pas pranimit të njoftimit për shkelje, ka arritur të jetë në pajtueshmëri me Rregullën në fjalë.
7. Radio Televizioni i Kosovës - RTK Televizion Publik ka bërë shkelje të Nenit 10.3 të Rregullës për Reklamim për Subjektet Transmetues CIMC-2007/06, palës i është dërguar njoftimi për shkelje, rasti është i hapur - bartet për procedim të mëtejshëm në vitin 2009.
8. KTV - Televizion Nacional ka bërë shkelje të Nenit 10.3. të Rregullës për Reklamim për Subjektet Transmetues CIMC-2007/06, palës i është dërguar njoftimit për shkelje, rasti është i hapur - bartet për procedim të mëtejshëm në vitin 2009.

## Shkelja e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës

### *Rastet e transmetimit pa të drejtë autoriale*

Gjatë vitit 2008, problemi i respektimit të të drejtës autoriale mbetet si një problem kyç edhe për industrinë mediale edhe për rregullatorin. Mos zbatimi i Ligjit mbi të Drejtën e Autorit dhe të drejtat e Përafërta, i cili është shpallur në gusht 2006, vështirëson edhe më shumë punën e KPM-së pasi që mbetet vetëm KPM të kujdeset për respektimin e të drejtës autoriale.

Subjektet transmetuese së bashku me operatorët kabllorë dhe ofruesit e shërbimit të programeve e kanë obligim sipas Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së që të respektojnë të drejtën e autorit dhe të sigurojnë kontrata valide për programet komerciale dhe për kanalet e ritransmetuara (operatorët kabllorë).

Divizioni Ligjor gjatë vitit 2008 ka proceduar 14 raste për shkelje të së drejtës autoriale:

1. *Eagle – Operator Kabllor* - ka bërë shkelje të Nenit 4.1.1 dh 4.1.2 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës. Përkundër faktit që i është dërguar Njoftimi për Shkelje, pala ka dështuar të jetë në pajtueshmëri me rregullën në fjalë, pala përgjegjëse është dënuar me gjobë, rasti i përfunduar.
2. *Kujtesa Net* - Operator Kabllor, ka bërë shkelje të Nenit 4.1.1 dh 4.1.2 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës. Përkundër faktit që i është dërguar Njoftimi për Shkelje, pala ka dështuar të jetë në pajtueshmëri me rregullën në fjalë, pala përgjegjëse është dënuar me gjobë, rasti i përfunduar.
3. *IPKO Telecommunication L.L.C.* ka bërë shkelje të Nenit 4.1.1 dh 4.1.2 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës. Përkundër faktit që i është dërguar Njoftimi për Shkelje, pala ka dështuar të jetë në pajtueshmëri me rregullën në fjalë, pala përgjegjëse është dënuar me gjobë, rasti i përfunduar.
4. *Tele Net* - Operator Kabllor, ka bërë shkelje të Nenit 4.1.1 dh 4.1.2 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës. Përkundër faktit që i është dërguar Njoftimi për Shkelje, pala ka dështuar të jetë në pajtueshmëri me rregullën në fjalë, pala përgjegjëse është dënuar me gjobë, rasti i përfunduar.
5. *Cablezone* - Operator Kabllor, ka bërë shkelje të Nenit 4.1.1 dh 4.1.2 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, pas Njoftimit për Shkelje, pala ka arritur të jetë në pajtueshmëri me rregullën në fjalë, rasti i përfunduar.
6. *Elektra* - Operator Kabllor, ka bërë shkelje të Nenit 4.1.1 dh 4.1.2 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës. Përkundër faktit që i është dërguar Njoftimi për Shkelje, pala ka dështuar të jetë në pajtueshmëri me rregullën në fjalë, pala përgjegjëse është dënuar me gjobë, rasti i përfunduar.
7. *Eagel - Operator Kabllor* - ka bërë shkelje të Nenit 4.1.1 dh 4.1.2 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, Përkundër faktit që i është dërguar Njoftimi për Shkelje, pala ka dështuar të jetë në pajtueshmëri me rregullën në fjalë, pala përgjegjëse është dënuar me gjobë, rasti është në procedurën e ankesës para Bordit të Ankesave për Media.
8. *TV Syri Vizion* - Televizion Lokal – ka bërë shkelje të Nenit 4.1.1 dh 4.1.2 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, Përkundër faktit që i është dërguar Njoftimi për Shkelje,

pala ka dështuar të jetë në pajtueshmëri me rregullën në fjalë, pala përgjegjëse është dënuar me gjobë, rasti është i hapur - bartet për procedim të mëtejshëm në vitin 2009.

9. TV Dukagjini - Televizion Lokal, ka bërë shkelje të Nenit 4.1.1 dh 4.1.2 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, Përkundër faktit që i është dërguar Njoftimi për Shkelje, pala ka dështuar të jetë në pajtueshmëri me rregullën në fjalë, pala përgjegjëse është dënuar me gjobë, rasti është i hapur - bartet për procedim të mëtejshëm në vitin 2009.
10. TV Besa - Televizion Lokal, ka bërë shkelje të Nenit 4.1.1 dh 4.1.2 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, Përkundër faktit që i është dërguar Njoftimi për Shkelje, pala ka dështuar të jetë në pajtueshmëri me rregullën në fjalë, pala përgjegjëse është dënuar me gjobë, rasti është i hapur - bartet për procedim të mëtejshëm në vitin 2009.
11. TV Prizreni - Televizion Lokal, ka bërë shkelje të Nenit 4.1.1 dh 4.1.2 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, Përkundër faktit që i është dërguar Njoftimi për Shkelje, pala ka dështuar të jetë në pajtueshmëri me rregullën në fjalë, pala përgjegjëse është dënuar me gjobë, rasti është i hapur - bartet për procedim të mëtejshëm në vitin 2009.
12. TV Opinioni - Televizion Lokal, ka bërë shkelje të Nenit 4.1.1 dh 4.1.2 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, pas Njoftimit për Shkelje pala ka arritur të jetë në pajtueshmëri me rregullën në fjalë, rasti i përfunduar.
13. TV Yeni Donem - Televizion Lokal, ka bërë shkelje të Nenit 4.1.1 dh 4.1.2 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, pas Njoftimit për Shkelje, pala ka arritur të jetë në pajtueshmëri me rregullën në fjalë, rasti i përfunduar.
14. *IPKO Telecommunication L.L.C* ka bërë shkelje të Nenit 2.1.3 dh 2.1.5 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës. Pas Njoftimit për Shkelje, pala ka arritur të jetë në pajtueshmëri me rregullën në fjalë, rasti i përfunduar.

### **Shkelja e Kodit të Sjelljes së Mediemeve Elektronike në Kosovë**

Dështimi i Palëve Përgjegjëse për sjelljen e materialit të arkivuar programore sipas kërkesës së KPM-së. Janë proceduar katër raste lidhur me këtë shkelje:

1. Tv Festina - Televizion Lokal, ka bërë shkelje të nenit 11.1 të Kodit të Sjelljes së Mediemeve Elektronike në Kosovë. Palës Përgjegjëse i është dërguar Njoftim për Shkelje, rasti është i mbyllur.
2. TV MIR - Televizion Lokal, ka bërë shkelje të nenit 11.1 të Kodit të Sjelljes së Mediemeve Elektronike në Kosovë. Palës Përgjegjëse i është dërguar Njoftim për Shkelje, rasti është i mbyllur.
3. TV Besa - Televizion Lokal, ka bërë shkelje të nenit 11.1 të Kodit të Sjelljes së Mediemeve Elektronike në Kosovë. Palës Përgjegjëse i është dërguar Njoftim për Shkelje, rasti është i mbyllur.
4. TV Most - Televizion Lokal, ka bërë shkelje të nenit 11.1 të Kodit të Sjelljes së Mediemeve Elektronike në Kosovë. Palës Përgjegjëse i është dërguar Njoftim për Shkelje, rasti është i mbyllur.

## **Rasti i proceduar lidhur me shkeljen e Ligjit të RTK-së**

Pala me numër ankese 2008/10, Radio Televizioni i Kosovës, ka bërë shkelje të Nenit 4 dhe 6.11 të Ligjit të RTK-së, palës përgjegjëse i është shqiptuar vërejtje me shkrim lidhur me shkeljen e bërë, rasti është mbyllur.

## **Rastet e paraqitura para Bordit të Ankesave për Media**

Ligji për KPM-në parasheh se Vendimet sanksionuese të Këshillit të KPM-së mund të Apeloohen në afat prej 30 ditëve nga dita e lëshimit të vendimit në Bordin e Ankesave për Media.

Gjatë vitit 2008 Bordi i Ankesave për Media ka shqyrtuar vetëm një rast.

Ankesa numër 2008/01, pala ka paraqitur ankesë ndaj vendimit licencues të Këshillit të KPM-së, me të cilin është vendosur që licencën për TV Lokale në Mitrovicë në gjuhën shqipe t'i lëshojë një aplikuesi tjetër. Bordi i Ankesave për Media ka refuzuar Ankesën Apeli si të pabazuar dhe mbështet vendimin e Këshillit të KPM-së për t'i dhënë licencë subjektit tjetër transmetues.

## **Divizioni i Menaxhimit Frekuencor**

Gjatë vitit 2008, DMF-ja ka shqyrtuar/proceduar raste të interferencave, ndërrim kanali të TV-ve, ndërrim të frekuencave të radiove, ndërrim të lokacionit, zgjerim të zonës së mbulimit, rritje të fuqisë së transmetimit etj.

Në rast të interferencave, pas pranimit të ankesës, DMF-ja bën matje teknike në teren dhe matë fuqinë e sinjalit të interferencës dhe me ndihmën e pajisjeve të monitorimit identifikon burimin e interferencës. Në rastet kur shkak i interferencës është një subjekt transmetues i licencuar brenda Kosovës, DMF-ja kontakton subjektin transmetues dhe këshillon atë të kontrollojë sistemin e transmetimit apo kur subjekti transmetues nuk është në pajtueshmëri me kushtet dhe termet teknike të licencës, KPM-ja urdhëron subjektin transmetues që shkakton interferencë, që të sillet në pajtueshmëri duke i dhënë instruksione të qarta se si ta bëjë atë.

### **Ndërrim të frekuencave**

TV MEN - për ndryshim të kanalit të transmetimit, dhe pas konstatimit se ka ndërhyrje të theksueshme në kanalën e transmetimit nga territori i Serbisë TV Fox, i është lejuar ndërrimi i kanalit deri në ri-licencim.

TV Vali – rast për ndryshim të kanalit të transmetimit. Për shkak të ndërhyrjes së theksueshme në kanalën e transmetimit nga territori i Serbisë, nga një TV i panjohur, i është lejuar ndërrimi i kanalit deri në ri-licencim.

TV Vali - ndërhyrje nga TV Iliria nga Vitia. Rasti është zgjidhur pasi që TV Iliria ka servisuar sistemin e paisjeve të veta.

TV Vali - për ndërrim të lokacionit, i është lejuar pasi që me ndryshimin e vendodhjes së transmetuesit nga lokacioni i vjetër në te riun, nuk kemi ndryshim të theksuar të zonës së mbulimit.

Radio Max – radio lokale serbe nga Gjilani, për intrefrencë nga Radio Presheva. Këtu është dashur të ndërrojmë frekuencën, pasi kemi konstatuar që ka ndërhyrje.

TV Prizrenit - nuk ju ka lejuar ndërrim i kanalit të kërkuar se nuk ka pasur arsyeshmëri të duhur për të bërë një ndërrim kanali. Drejtori i TV Prizrenit ka bërë një kërkesë për ndryshimin e kanalit të

transmetimit nga kanali 60, për të cilin është i licencuar, në kanal 28, si dhe ka kërkuar që pas këtij ndryshimi t'i mundësohet edhe më tutje shfrytëzimi i kanalit 60, me qëllim që TV Prizreni me program të tij të mbulojë disa zona të cekura në kërkesë (Opojë dhe Dragash).

### **Ndërrim lokacioni**

Ju është është lejuar katër subjekteve transmetuese: Radio As nga Zveçani, Radio Top Iliria nga Deçani, Radio Kaçanikut, Radio Malishevës.

Në raste të tilla ekipi i DMF-se ka dalë ne teren dhe ka marrë koordinatat e lokacionit të propozuar për ndryshim dhe sipas vlerësimit të DMF-së kalimi i Radio Top Iliria nga vendi i licencuar në lokacionin e ri nuk do të ketë ndryshime në zonën e mbulimit dhe nuk do të ketë ndryshime të pjesës 2 dhe 4 të licencës së KPM-së dhe propozon që t'i lejohet.

Ndërsa Radio Kllokotit kërkesa për ndërrim të lokacionit i është refuzuar. Pas monitorimit ne teren dhe marrjes së koordinatave dhe analizes softverike të mbulimit, shihet se me ndryshimin e lokacionit, ka ndryshime të theksuara në zonën e mbulimit të Radio Kllokotit e aq më tepër që Radio Kllokoti është subjekt me fuqi të ulët.

TV Pulsit - nuk ju ka lejuar zgjerimi i zonës së mbulimit për faktin se ky subjekt kërkonte edhe një lokacion të ri, që sipas ligjit do të thotë edhe një frekuencë të re, e që sipas ligjit tonë nuk lejohet.

Si rezultat i këtyre matjeve dhe kërkesës së Këshillit të KPM-së nga takimi i Shkupit për rilicensim dhe digjitalizim nga DMF-ja, janë hartuar këto Plane Frekuencore:

1. Plani frekuencor VHF/Fm të Kosovës,
2. Plani Frekuencor Televiziv i Kosovës me Goleshin dhe
3. Plani tjetër pa Goleshin për TV.

Nga këto Plane Frekuencore shihet se problem të veçantë përbëjnë frekuencat që shfrytëzojnë KFOR-i në punktet tona primare në Golesh, Maja e Gjelbërt dhe Cernushë, frekuenca që nuk figurojnë në Planin Gjeneva 84. Në mënyrë që KFOR-i në të ardhmen t'i shfrytëzojë këto frekuenca pa ndonjë interferencë nga jashtë, duhet të kordinohet me shtetet për rreth Kosovës.

Po ashtu gjatë kësaj periudhe personeli i DMF-së është përgatitur profesionalisht përmes trajnimeve dhe takimeve të ndryshme rreth digjitalizimit. Mund të veçohet takimi në Shkup në muajin korrik, ku mund të ceket si takimi i parë rreth digjitalizimit, ku ishin pjesëmarrës ekspertë të vendeve të ndryshme, të cilët e kishin përfunduar apo ishin në përfundim të kalimit nga transmetimet Analoge ne ate Digjitale.

Trajnimet profesionale janë realizuar në Rumani me kompaninë ATDI dhe në Gjermani me kompaninë LS Telecom. Trajnimet janë bërë për përdorim të i Softëare-it ICS Telecom dhe për sistemet T-DAB, DVB-T, dhe Broadcat Antennas sipas rekomadimeve të ITU-së.

### **Situata në brezin frekuencor dhe problemi me pikat e transmetimit Golesh dhe Cvilen**

Aktualisht në territorin e Kosovës në shfrytëzim janë 192 kanale frekuencore ku përfshihen 146 FM kanale dhe 46 TV kanale. Frekuencat janë të ndara për pesë lloj shërbimesh ku të gjitha këto frekuenca përdoren nga pesë (5) lloj i mediave:

- |                                 |  |
|---------------------------------|--|
| - 3 TV + 4 FM Media Nacionale   | - 4 FM Internacionale                  |
| - 5 TV + 29 FM media te KFOR-it | - 2 FM te UNMIKUT dhe të tjerat lokale |



KFOR-i pos shfrytëzimit të frekuencave FM dhe TV, shfrytëzon si pikë transmetimi edhe Majën e Goleshit, e cila nuk shfrytëzohet nga mediat kosovare. KPM që në qershor 2008 i është drejtuar me shkrim KFOR-it duke ngritur si çështje problematike që kërkon zgjidhje emergjente problemin me pikat e transmetimit të Goleshit dhe Cvilenit, të cilat nuk janë në shfrytëzim nga subjektet transmetuese kosovare. Shfrytëzimi i pjesës së sipërme të Goleshit do t'u mundësonte mediave transmetuese, radio dhe TV që të mbulojnë afërsisht edhe 12% më tepër të popullatës së Republikës së Kosovës (dmth. Do të zgjidhej edhe çështja e mbulimit të RTK-së siç është e obliguar me ligj). Përdorimi i kësaj pjese do të mundësonte mbulimin e pjesës veriore të Kosovës, të banuar kryesisht me popullatën minoritare serbe.

Sipas KFOR-it, kjo pikë strategjike nuk do të mund të shfrytëzohet për shkaqe sigurie.

***Sugjerime për Kuvendin e Kosovës për çështjen e KFOR-it, mbulueshmërisë së RTK-së dhe anëtarësimin e Kosovës në ITU***

1. Kuvendi i Kosovës si themelues i RTK-së të mundësojë, në marrëveshje me KFOR-in, shfrytëzimin e majës së Goleshit për transmetimet televizive, pikë transmetuese kjo, e paraparë me dokumentet ndërkombëtare të konferencave "Stokholmi 61", "Gjeneva 84" dhe "Gjeneva 2006".
2. Kuvendi i Kosovës të sigurojë mjete finaciare për investime në infrastrukturë në pikën e Goleshit dhe në rrjetin sekondar të televizionit publik, me qëllim të mbulimit me sinjal TV të pjesës veriore të Kosovës, të Komunës së Dragashit, të regjionit të Zhupës si dhe lokaliteteve Kaçanik, Shtërpçë, Skënderaj dhe Therandë.
3. Kuvendi i Kosovës të mundësojë (të gjejë mënyrat) për anëtarësimin e delegacionit të Kosovës në ITU, në mënyrë që KPM-ja të fillojë procesin e koordinimit të frekuencave me shtetet e rajonit.

**Departamenti i Administratës**

Gjatë vitit 2008 ka kryer detyrat e veta në relacion me çështjet buxhetore, prokurimit, personelit dhe logjistikës. Janë përfunduar 25 procedura kuotimi të hapur (3 të negociuara pa publikime) dhe 16 procedura kuotimi për vlerë minimale. Në aspektin e personelit, janë ndjekur procedurat e rekrutimit për 5 punëtorë të rinj (ndërsa janë larguar 7).

**Buxheti (**

Komisioni i Pavarur për Media është organizatë buxhetore e financuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Për vitin 2008 KPM-së i është ndarë buxhet prej 557,606.00 Euro duke përfshirë edhe investimin kapital prej 150,000.00 Euro.

<b>Buxheti i Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2008</b>			
Kategoritë	Buxheti i alokuar/aprovuar	Buxheti i shpenzuar	Buxheti i pashpenzuar
Paga dhe mëditje	84,397.00	82,787.00	1,609.00
Mallra dhe shërbime	303,209.00	289,216.00	13,992.00
Shërbime komunale	20,000.00	10,327.00	9,673.00
Shpenzimet kapitale	150,000.00	140,273.00	9,727.00
<b>Total</b>	<b>557,606.00</b>	<b>522,603.00</b>	<b>35,003.00</b>

Paraqitja e buxhetit në formë tabelare

Buxheti i KPM-së është realizuar për 93%. Në Shtojcën xx është dhënë raporti buxhetor i detajuar, i cili paraqitet edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe në Ministrinë për Ekonomi dhe Financa.

Projekti kapital është realizuar me 140.273.00 euro nga 150,000.00 të ndara nga Qeveria.

Ky projekt është planifikuar të realizohet në disa komponenta dhe në disa faza:

- azhurnimin e Softverit ICS Telekom versioni 9.2,
- pajisjet kompjuterike (hardverike) dhe
- trajnimet e personelit teknik për menaxhim frekuencor dhe
- grupet punuese.

- 1) Është kërkuar leje nga APP me datë 21.04.2008 për kontratë një burimore për komponentën e parë softuerike, që në të vërtetë ka qenë vazhdimësi e softuerit, të cilin e posedon KPM nga viti 2003 dhe i cili është donacion nga OSBE-ja. Pas miratimit të kërkesës nga APP, më 17 qershor 2008 është nënshkruar kontrata me kompaninë prodhuese të softuerit ATDI, me seli në Rumani. Kjo kontratë ka arritur vlerën prej 49,300.00 dhe pjesë e kësaj kontrate kanë qenë 3 licenca të reja dhe trajnimi një javor i stafit teknik.
- 2) Komponenta harduerike ka filluar të realizohet me datën 20.06.2008 kur është shpallë tenderi për blerjen e pajisjeve të nevojshme për instalimin e softuerit. Më 20.07.2008 është mbyllur edhe pjesa harduerike.
- 3) Trajnimet janë realizuar në dy faza, njëra si pjesë e marrëveshjes me kompaninë ATDI dhe tjetra me aprovimin e kërkesës për trajnim në APP me datën 10.08.2008, e cila ka rezultuar me nënshkrim të kontratës më 01.09.2008. Kostoja e kontratës ka qenë 28,393.00 euro.
- 4) Grupet punues me ekspert vendorë dhe ndërkombëtarë.

#### *Të hyrat e inkasuara nga pagesa e taksës për licencë në vitin 2008*

KPM-ja ka filluar me të hyra nga mbledhja e taksës për licencë prej muajit gusht të vitit 2008, ku janë gjeneruar gjithsej 57,329.65 Euro të hyra nga taksa për licencë nga:

- Subjektet transmetuese:	shuma 38,880.27 Euro
- Operatorët kabllorë:	shuma 17,149.38 Euro
- Ofruesit e shërbimeve programore:	shuma 1,300.00 Euro

Në vitin 2009 të hyrat e përafërta që do të inkasohen nga taksa për licence do të arrijnë shumën prej 143,228 Euro:

- Subjektet transmetuese:	shuma 93,780 Euro
- Operatorët kabllorë:	shuma 39,503 Euro
- Ofruesit e shërbimit të programeve:	shuma 9,945 Euro

#### **Sfidat e Zyrës gjatë vitit 2008**

Zyra është ballafaquar me shumë probleme si rezultat i problemit me humbjen e stafit dhe me afatet e stërgjatura të emërimeve të Këshillit, të cilat shpesh kanë rezultuar me pothuajse bllokim total të veprimtarisë dhe me vonesa në kryerjen e detyrave.

### *Problemet buxhetore - Pagat e personelit të Zyrës së Shefit Ekzekutiv*

KPM gjatë vitit 2008 ka arritur të përmbushë shumicën nga obligimet ligjore dhe objektivat e përcaktuara, mirëpo jo të gjitha, sepse problemi i financimit, respektivisht buxheti i limituar i KPM-së, ka vazhduar të paraqesë probleme në realizimin e detyrave të KPM-së dhe ka dobësuar efikasitetin e tij si rregullator. Personeli i KPM-së janë shërbyes civilë dhe paguhen sipas skemës së pagave të përcaktuara nga MSHP-ja, që janë jashtëzakonisht shumë të vogla dhe nuk ofrojnë mundësi që KPM të mbajë stafin profesional.

Gjatë vitit paraprak, 2007, KPM ka humbur 6 punëtorë, ndërsa gjatë vitit 2008 KPM ka humbur tetë punëtorë në pozita kyçe:

- një zyrtar të lartë për menaxhim frekuencor;
- dy persona në pozitën e udhëheqësit të divizionit ligjor;
- zyrtar i lartë ligjor
- tre menaxherë për monitorim (dy prej tyre kanë qenë nga komuniteti minoritar; një serbe dhe një boshnjake), dhe
- një asistent ligjor

Humbja e personelit, të trajnuar dhe të përgatitur profesionalisht nga KPM, ka ndikuar që të ketë vonesa në realizimin e projekteve të filluara (siç është procesi i rilicencimit). Financiarisht buxhetit të Kosovës, respektivisht buxhetit të KPM-së, kjo humbje i ka kushtuar 20.000 Euro vetëm për shpalljet e konkurseve dhe ripërsëritjet e tyre disa herëshe për vende të lira të punës. KPM-së i janë shtuar obligimet me licencimin e operatorëve kabllorë dhe ofruesve të shërbimit të programeve, ndërsa në anën tjetër i janë larguar personeli kyç, duke përfshirë edhe monitorimin i cili duhet të jetë shumë aktiv, në mënyrë që KPM të jetë funksional.

KPM është përgjegjëse për implementim të Ligjit dhe duhet të japë llogari për punën e vet, mirëpo për të kryer me sukses misionin e vet, për të cilin është themeluar KPM, duhet të ketë staf profesional të punësuar. KPM humbë punëtorët për shkak të pagave. KPM investon në personel në zhvillimin e tyre profesional, mirëpo i humb shpejt për faktin që sektori privat ofron më shumë. Rregullatori i transmetimit duhet të jetë në gjendje që të punësojë staf profesional, të jetë në gjendje që të mbajë stafin duke qenë financiarisht i fuqishëm.

### *Sfidë ka qenë edhe puna e Zyrës në mungesë të Këshillit të kompletuar*

Sipas strukturës së Komisionit të Pavarur për Media, Këshilli është organi vendimmarrës. Zyra e Shefit Ekzekutiv mundet të procedojë me rastet vetëm deri në një masë dhe pastaj vetëm i bën rekomandime Këshillit për vendime. Zyra po ashtu duhet të ekzekutojë vendimet e Këshillit. Me mungesë të personelit të Zyrës por edhe me mungesë të Këshillit të kompletuar, puna e KPM-së ndodh që ndalohet tërësisht. Me faktin që pas krijimit të Këshillit dy prej anëtarëve të tij janë emëruar me mandat një vjeçar për dallim prej të tjerëve që kanë mandate dyvjeçare, është krijuar nevoja që çdo vit të bëhen nominime të reja për Këshill. Pavarësisht fillimit të procedurave me kohë nga Zyra e Shefit Ekzekutiv, siç janë paraparë me Ligjin për KPM, për nominimin e anëtarëve në Këshillin e KPM-së nga shoqëria civile, vonesat e mëdha nga Kuvendi për emërimin e tyre kanë shkaktuar shumë probleme duke sjellë KPM-në në situatë të mosveprimit. Rastet e inicuara janë zhvilluar deri në atë masë sa është dashur të mirret vendim, mirëpo në mungesë të kuorumit të Këshillit për shkak të mungesës së anëtarëve nuk ka pasur mundësi të vendimmarrjes dhe KPM është vonuar me mbyllje të rasteve në afate kohore të arsyeshme.

### **BORDI I ANKESAVE PËR MEDIA**

Gjatë vitit 2008 para BAM-it është paraqitur vetëm një ankesë ndaj një vendimit të Këshillit dhe BAM-i është takuar vetëm një herë.

Përkundër rastit me Këshillin e KPM-së që është kosovarizuar, BAM-i vazhdon të funksionojë ende me përbërje të përzier edhe pse është inicuar procedura për zëvendësim të anëtarit ndërkombëtar të BAM-it.

#### **Procesi i nominimit për anëtarin e tretë**

Zyra e Komisionit të Pavarur për Media më 6 gusht 2008 deri me 6 shtator 2008, ka bërë ftesën publike për nominim të Anëtarit të Bordit të Ankesave për Media për ta zëvendësuar anëtarin ndërkombëtar të Bordit duke u bazuar në obligimin ligjor të cekur në Nenin 22.6 Ligjit të KPM-së, i cili thekson se *“Pas arritjes së statusit përfundimtar të Kosovës, Bordi i Ankesave për Media përbëhet vetëm nga vendorët”*.

Zyra e Komisionit të Pavarur për Media gjatë periudhës së nominimit ka pranuar gjithsejt tri nominime, të cilat ia ka përcjellur Gjykatës Supreme me datën 10 tetor 2008. Nominimet i dërgohen Gjykatës në pajtueshmëri me Nenin 22.4 të Ligjit të KPM-së, i cili thekson se *“Anëtarët vendorë të Bordit të Ankesave për Media caktohen nga Gjykata Supreme e Kosovës, dhe emërohen nga Kuvendi i Kosovës pas kërkesës publike të emërimeve nga Këshilli”*.

Këto nominime ende qëndrojnë me Gjykatën Supreme. Pritet që të procedohen tutje në Kuvend për emërim të anëtarit të tretë.

# **OBLIGIMET KARSHI SUBJEKTIT TRANSMETUES PUBLIK – RADIO TELEVISIONIT TË KOSOVËS (çështja e reklamimit dhe nominimet për Bordin e RTK-së)**

## ***Reklamimi***

Me nenin 17 të Ligjit mbi KPM-në dhe Transmetimin, kërkohet që të përcaktohet politika e qasjes së transmetuesit publik në reklamim, duke përfshirë edhe sponsorimet dhe të bëhen kufizime në reklamim.

Në korrik 2007 është nxjerrë Rregulla për reklamim për subjektet transmetuese, e cila rregullon përmbajtjen e reklamës dhe etikën në transmetuesin publik dhe transmetuesit privatë, mirëpo ajo rregull nuk rregullon sasinë e reklamës së transmetuar nga transmetuesi publik, gjë që është thënë të bëhet përmes një akti të veçantë.

KPM nuk arriti ta bëjë, për faktin që në gusht 2007, u paralajmërua ndërprerja e kontratës në mes KEK-ut dhe RTK-së për parapagimin e RTK-së dhe kjo paraqiste problem për qëndrueshmërinë financiare të RTK-së. Kjo situatë vazhdoi edhe gjatë gashëmujorit të parë të vitit 2008, ku edhe përkundër disa tentativave për zgjedhje të problemit përmes një Task Force, çështja e parapagimit mbeti diskutabile. Sidoqoftë, tani marrëveshja në mes KEK-ut dhe RTK-së është vazhduar deri në nëntor 2009 dhe Këshilli i KPM-së do të caktojë rregullat dhe kuzifimet për reklamën në RTK.

Në takimin e Këshillit më 12 janar dhe 12 shkurt 2009 është diskutuar kjo çështje dhe është vendosur që duhet të bëhet ndryshimi i Rregullës për Reklamim CIMC 2007/06, duke përcaktuar brenda këtij akti nënligjor edhe kushtet e reklamës dhe kufizimet për subjektin transmetues publik në atë mënyrë që të mos dëmtohet RTK-ja, por në të njëjtën kohë të sigurohet një konkurrencë e ndershme me mediat private. Është parim i përgjithshëm që subjekti transmetues, duke qenë i financuar nga publiku përmes taksës për licencë duhet të ketë minutazh të limituar të reklamës dhe sponsorimit.

## ***Procesi i nominimit të Bordit të RTK-së***

Çështja e nominimit dhe emërimit të Bordit të Transmetuesit Publik ka mbetur çështje më e përfolur gjatë vitit 2008 dhe shpeshherë gabimisht është adresuar tek Komisioni i Pavarur për Media për dështimin e krijimit të atij Bordi. Për të sqaruar pozicionin e KPM-së në tërë këtë proces, përmes një komunikate për shtyp është bërë sqarimi që në bazë të ligjit të RTK-së, përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të Bordit të RTK-së bëhet nga një Komision Ad-hoc i cili përbëhet nga këto institucione:

1. Një i deleguar i Akademisë së Shkencave, njëherit edhe Kryesues i Komisionit Ad – hoc;
2. Tre Anëtarë të Bordit të RTK-së;
3. Tre Anëtarë të Këshillit të KPM-së.

Ky Komision dërgon listën e nominimeve në Kuvend. Kuvendi formon një Komision tjetër Ad Hoc, që i shqyrton nominimet e dërguara nga Komisioni Ad-Hoc.

Roli i KPM-së në këtë proces, në bazë të ligjit për RTK-në, është:

- të bëjë ftesën publike për propozime (nominime);
- në konsultim me Bordin e tanishëm të RTK-së të përcaktojë dhe publikisht t'i shpallë kriteret për zgjedhjen e kandidatëve për secilën pozitë;

- t'i nominojë 3 anëtarë të Këshillit të KPM-së për Komisionin Ad Hoc dhe të shërbejë si Sekretari e punës së Komisionit Ad Hoc.

Çështja e Bordit të RTK-së është paraqitur sërish në vitin 2008, edhe pse edhe në vitin paraprak ishin ndjekur të gjitha procedurat për nominim dhe qysh nga 8 qershori 2007 Kuvendit i ishin vënë në dispozicion 18 nominimet për 9 pozita.

15 Maj 2008	Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës i dërgoi shkresë KPM-së të ri-procedon më shpalljen publike për zgjedhjen e kandidatëve për Bord të RTK-së;
20 Maj 2008:	KPM bëri kërkesën tek Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës për të dërguar të nominuarin e tyre për të Kryesuar Komisionin Ad Hoc;
21 Maj 2008:	KPM u takua me Kryetaren e Bordit të RTK-së për t'i finalizuar kriteret për zgjedhjen e kandidatëve;
22 Maj 2008:	U publikua ftesa për nominime. Për të respektuar kërkesën e Kuvendit të Kosovës për shpejtësi të procesit, KPM-ja shkurtoi periudhën e nominimeve prej 1 muaj në 3 javë;
9 qershor 2008:	RTK-ja dërgoi të tre emrat e tyre për Komisionin Ad Hoc;
13 Qershor 2008:	Mbyllet konkursi për nominime.

Pas përfundimit të afatit për nominime, KPM-ja bëri procesimin e nominimeve dhe kërkoi mbajtjen e mbledhjes së parë për datën 29 qershor 2008. Për shkak të mospërputhjes së orareve të anëtarëve të Bordit të RTK-së dhe Kryesuesit të Komisionit Ad-Hoc, mbledhja e parë e paraparë për datën 29 qershor 2008, shtyhet.

9 Korrik 2008:	Mbahet mbledhja e parë e Komisionit Ad Hoc
30 korrik 2008:	Mbledhja e dytë
1 gusht 2008:	Mbledhja e tretë
3 shtator 2008:	Mbledhja e katërt
10 shtator 2008:	Mbledhja e pestë
23 shtator 2008:	Rihapet konkursi për nominime shtesë
7 tetor 2008:	Mbyllet konkursi për nominime shtesë
13 tetor 2008:	Caktohet mbledhja e ardhshme e Komisionit Ad Hoc
28 tetor 2008;	Takimi i fundit i Komisionit Ad-Hoc i cili bëri përzgjedhjen e Tetëmbëdhjetë (18) kandidatëve nga lista e të nominuarve, prej të cilëve Kuvendi i Kosovës do të duhej të zgjedhte nëntë (9) anëtarë të Bordit të RTK-së

Lista me emra i është dërguar Kuvendit të Kosovës nga Komisioni Ad-Hoc më 30 tetor 2008. Komisioni i Pavarur për Media ka kryer në tërësi obligimet e veta në procesin e nominimit për anëtarë të Bordit të RTK-së. Procedura ka mbetur të vazhdohet në Kuvend, e cila duhet të rezultojë me emërimet e anëtarëve që do të krijojnë Bordin e ri të RTK-së, të parin të zgjedhur sipas Ligjit të RTK.